



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3 të Rregullorës së UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe Rregullave të Procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2003, merr

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT
PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË KATEDRALËS KATOLIKE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike në Prishtinë.

Neni 2

Neni 2 i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike në Prishtinë nr. 01-353-1773 të datës 24.09.2002 ndryshohet dhe bëhet:

“Për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike caktohet ngastra kadastrale nr. 7355 Komuna Kadastrale Prishtinë në sipërfaqe prej 1,30 ha pronë e Komunës”.

Neni 3

Neni 3 i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike në Prishtinë nr. 01-353-1773 të datës 24.09.2002, plotësohet me aline të re ku thuhet:

“Shfrytësuesi i lokacionit për ndërtimin e objektit sipas këtij Vendimi është i obliguar që, para fillimit të punimeve për ndërtimin e objektit, për të cilin është dhënë në shfrytëzim ky lokacion të bëjë ndërtimin e objektit të ri shkollor për sh.m gjimnazin “Xhevdet Doda” në lokacionin e caktuar nga Komuna.”

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 NR. 353-263 DT. 04.03.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri

ARSYETIM
I PROPOZIM VENDIMIT MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
VENDIMIT MBI ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT
TË KATEDRALËS KATOLIKE NË PRISHTINË

Ipeshkëvia e Kishës Katolike të Kosovës i është drejtuar kuvendit Komunal dhe organeve ekzekutive të tij me kërkesë për caktimin e lokacionit dhe dhënien e tokës në shfrytëzim për ndërtimin e objektit të katedralës në Prishtinë.

Kjo kërkesë i është përcjellë në përgjegjësi Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë për gjetjen e lokacionit të përshtatëshëm dhe propozimin për ndërtimin e objektit të ndërtuar. Ky Drejtorat, pas analizave të hollësishtme, i ka propozuar Bordit të Drejtorëve, trupave të Kuvendit Komunal dhe Kuvendit Komunal që si lokacion i mundëshëm për ndërtimin e objektit në fjalë të caktohet ngastra kadastrale 6198 Komuna Kadastrale e Prishtinës në sipërfaqe 1.20 ha kështu që, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datën 19.09.2002 ka miratuar Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike të protokoluar me nr. 01-353-1773 të datës 24.09.2002.

Kërkuesi përkatësisht Ipeshkëvia e Kishës Katolike të Kosovës nuk është pajtuar me lokacionin e caktuar me këtë Vendim kështu që përmes Institucioneve përkatëse komunale ka kërkuar ndryshimin e Vendimit të miratuar përkatësisht ndërtimin e lokacionit të caktuar me propozim konkret të tyre që për ndërtimin e këtij objekti të caktohet ngastra kadastrale 7355 Komuna Kadastrale e Prishtinës.

Pas konsultimeve paraprake me të gjitha organet përgjegjëse të Kuvendit Komunal, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë ka pregaditur propozim vendimin mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të katedralës katolike në Prishtinë të miratuar në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit të Komunës së Prishtinës me datën 19.09.2002 me ç`rast Vendimi i miratuar është ndryshuar në aspektin e ndërtimit të lokacionit të caktuar. Po ashtu me këtë propozim vendim, neni 3 i vendimit të miratuar është plotësuar me aline të re me të cilën është obliguar që shfrytëzuesi i këtij lokacioni të obligohet që para fillimit të punimeve ndërtimore për ndërtimin e objektit të kërkuar, të ndërtoj shkollën e re pasi që, në lokacionin e caktuar sipas këtij propozim vendimi ekziston Shkolla e Mesme-Gjimnazi "Xhevdet Doda".